



Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 dhe Plotësim ndryshimit të UA 03/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik si dhe në bazë të Kodit të punës nr.804 i datës 28.01.2025 së KEK sh.a, si dhe nevojave emergjente të paraqitura për plotësimin e vendit të lirë të punës në Divizionin Financiar në KEK.sh.a, UD Kryeshefi Ekzekutiv i KEK-ut autorizon Drejtorin e Burimeve Njerëzore, më 14.04.2025 që të publikojë ofertën për pozitën e mëposhtme:

K O N K U R S

Titulli i pozitës:	MENAXHER PËR BLERJE DHE LLOGARI TË PAGUESHME
Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës
Numri i referencës:	06-14.04.2025
Tipi Akt Emërimit të punës:	Sipas Ligjit të punës 03/L-2012 , UA01/2024,plotësim ndryshimi i UA 03/2025 dhe Kodi i punës së KEK-ut
Titulli i mbikëqyrësit:	I raporton Menaxherit të Kontabilitetit dhe Drejtorit Financiar
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Koeficienti-paga:	1620 Euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	1
Vendi i punës:	Korporata Energjetike e Kosovës -Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bartësi i vendit të punës është Mbikëqyrja dhe menaxhimi i procesit të pagesave të furnitorëve dhe llogarive të pagueshme. Monitorimi i transaksioneve të blerjeve, sigurimi i përputhshmërisë me kontratat dhe rregulloret financiare. Zhvillimi dhe implementimi i politikave të kontabilitetit për llogaritë e pagueshme, duke siguruar një proces efikas dhe të standardizuar. Sigurimi i saktësisë së të dhënave të blerjeve, duke verifikuar urdhrat për blerje, faturat dhe dokumentacionin përkatës. Monitorimi dhe koordinimi i pagesave të furnitorëve, duke siguruar respektimin e afateve dhe evitimin e vonesave. Mbikëqyrja e përputhshmërisë financiare dhe kontabël të blerjeve me buxhetin e miratuar dhe standardet e kontabilitetit (IFRS). Koordinimi me departamentet e tjera për barazimin e transaksioneve dhe përgatitjen e raporteve financiare mbi llogaritë e pagueshme. Përgatitja e raporteve financiare dhe analizave mbi shpenzimet e blerjeve dhe detyrimet ndaj furnitorëve. Sigurimi i respektimit të politikave të kontraktimit dhe kushteve të pagesave, duke shmangur penalitetet dhe gjobat. Menaxhimi dhe trajnimi i ekipit të llogarive të pagueshme për të siguruar efikasitet dhe përputhshmëri me rregulloret financiare. Bashkëpunimi me auditorët e brendshëm dhe të jashtëm për të siguruar transparencë dhe kontroll të plotë mbi transaksionet e blerjeve

I raporton: I raporton Menaxherit të Kontabilitetit dhe Drejtorit Financiar

Kërkesat profesionale/Kualifikimet

Diplomë universitare në Kontabilitet, Financë, Ekonomi ose një fushë të ngjashme.
Minimum 5 vite përvojë në kontabilitet, llogaritë e pagueshme ose menaxhimin e financave.
Preferohet të jetë i certifikuar në njërin nga shoqatat e licencuara (ACCA, SCAAK, etj.).
Njohuri të avancuara mbi procedurat e pagesave të furnitorëve dhe menaxhimin e llogarive të pagueshme.
Eksperiencë me kontratat, kushtet e pagesave dhe menaxhimin e detyrimeve financiare.
Njohuri mbi softuerët financiarë dhe kontabël (ORACLE, Microsoft Dynamics, ose të ngjashme).
Njohuri të thelluara mbi standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (IFRS) dhe ligjet tatimore në Kosovë.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

- Aplikacionin e shkarkuar nga web faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online të vegëza: **“Ngarko Aplikacionin e plotësuar”**
- Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomë universitare në Kontabilitet, Financë, Ekonomi ose një fushë të ngjashme** e skanoni në një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe pastaj e ngarkoni në aplikimin online të vegëza **“Ngarko dëshmitë e kualifikimit”** “ si dhe dëshminë e përvojës së punës e dokumentoni me trust e me kontrat pune.

Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

Mënyra e aplikimit

Aplikimi është online, ngarkoni dokumentet sipas kërkesave në konkurs. Aplikimi juaj është i kompletuar vetëm nëse e merrni e-mailin konfirmues. Për çdo paqartësi dhe për siguri në aplikim kontaktoni në numrin e telefonit: 038 501-401-2671, por mund të shkruani edhe në e-mailin (ofertapune@kek-energy.com) për të vërtetuar aplikimin tuaj (vetëm nëse nuk keni pranuar e-mailin konfirmues).

Njoftimi me rezultatin e konkursit publik

Kandidatët do të njoftohen individualisht me rezultatin e këtij konkursi duke e respektuar Udhëzimin administrativ nr. 01/2024. plotësim ndryshimin e UA 03/2024 dhe Kodin e punës nr.804 të datës 28.01.2025 për rregullimin e konkursit në sektorin publik.

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve:

Intervista deri në shtatdhjet (70) pikë;

Jetëpërshkrimi (CV) deri në tridhjet (30) pikë.

KEK-u fton të gjithë të interesuarit, në veçanti ato të gjinisë femërore, të aplikojnë për pozitën e publikuar.

Për më shumë informata për pozitën e lartpërmendur vizitoni web-faqen: www.kek-energy.com, ikona 'Shpallje' dhe mund ta shkarkoni aplikacionin për pozitën që aplikoni.

Në rast të pikëve të barabarta në fund të testimit (me gojë) përparësi do të kenë kandidatët nga komuna e Obiliqit dhe zonat tjera të rrezikuara konform ligjit nr. 05/l-044.

Vërejtje:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes si në vijim: **Nëse nuk e deklaroni që anëtar i familjes së ngushtë ju punon në KEK, në cilëndo fazë që vërtetohet, aplikacionet e juaja do të refuzohen.** Aplikacionet pas afatit nuk do të pranohen, ndërsa ato të mangëta ose që nuk janë në formatin e kërkuar më lartë do të refuzohen. Kandidati i suksesshëm do të sistemohet në pozitën për të cilën ka aplikuar sipas kësaj shpalljeje dhe në afatin prej 3 (tri) viteve nga dita e kontratës së parë nuk ka të drejtë ri-sistemimi në vend tjetër të punës, përveç në raste të jashtëzakonshme me lejinimin e KE të KEK. Kalendar i përafërt: brenda 25 ditësh intervistat me gojë dhe njoftimi final brenda 30 ditësh nëse nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë sipas UA01/2024, plotësim ndryshimi i UA 03/2024 dhe në bazë të Kodit të punës 804 të datës 28.01.2025.

**Data e aplikimit deri më 29.04.2025 ora 24:00
Prishtinë, 14.04.2025**

Divizioni i Burimeve Njerëzore

